
Lënda: Informacion i pjesshëm në lidhje me inspektimin e objekteve të finacuara nga Bashkia Tiranë për periudhën kohore nga viti 2010 deri në vitin 2018.

Objekti: **Rikonstruksion i rrugës Danish Juniku, Tiranë**

Investitori: **Bashkia Tiranë**

Vlera e Investimit: **44,758,412 lekë**

Periudha kohore: **Qershor 2017 deri në maj 2018**

Inspektimi është kryer: **Shkurt 2019**

Ky objekt zbatohet në qytetin e Tiranës në një zonë periferike të saj, në zonën e Saukut. Segmenti rrugor nis nga bashkimi i "Danish Juniku", me rrugën kryesore "Ruga e Elbasanit"(në afërsi të ambienteve të Policisë Ushtarake)dhe përfundon në anën jug-perëndimore të segmentit rrugor, në afërsi me rrethimin e Autostradës Tiranë-Elbasan,me një gjatësi të përgjithshme rreth 630 ml. Gjendja ekzistuese e rrugës ka qenë e amortizuar dhe e shtruar vetëm pjesërisht,ndërkohë që pjesa fundore e saj, ka qenë pothuajse e pa asfaltuar.

Projekti ka ndërhyrë në rehabilitimin e gjithë shtresave rrugore të trupit të rrugës (shtrimi me binder dhe shtrimin me asfalt), në rehabilitimin e plotë të gjitha nënshtresave të trupit të rrugës me të gjithë komponentët e saj (çakëll+stabilizant), në rehabilitimin e rrjetit të ujërave të bardha, me sistemimin e kanalizimive të pusetave të ujërave të zeza, në sistemimin e trotuarëve, në rehabilitimin e rrjetit të ndriçimit, në sinjalistikë rrugore, rehabilitimin e mureve rrethuese të ndërtesave pranë kësaj rruge (sipas një modeli standard te miratuar), etj. Projekti zbatimit ka parashikuar një rikonstruksion të përgjithshëm të këtij segmenti rrugor.



Fig. 1
Cilesi e mire e shtresave asfaltike dhe
pllakave te trotuareve

Punimet kanë filluar në qershor të vitit 2017, ndërkohë që është bërë inagurimi për përfundimin e saj në muajin maj të vitit 2018, që përkon edhe me përfundimin e deklaruar nga Bashkia Tiranë. Afati i garancisë së punimeve për këtë objekt ndërtimi është dy vjet. Pra, rezulton se afati kohor

i garancisë së punimeve të veprës, akoma nuk ka përfunduar. Zbatimi i punimeve është bërë në kushte optimale, pasi rruga ka pasur trafik pothuajse të bllokuar gjatë gjithë periudhës kohore të ndërtimit të saj. Edhe pse objekti sapo është përfunduar dhe është brenda periudhës kohore të garancisë së punimeve, vlerësimi i punës së kryer mund të vlerësohet kalueshëm.

Nga pamja vizuale e objektit konstatohet se:

- Në trupin e rrugës nuk u vunë re ulje apo plasaritje të shtresave të asfaltit. Lidhja e trupit kryesor të rrugës me rrugët e brendshme që lidhin banesat midis tyre, nuk janë kryer sipas standardit të kërkuar. Ka prurje të ujërave të bardha e materiale inerte (gjatë rreshjeve të shiut) në trupin e rrugës kryesore nga këto segmente rrugore. Projekti zbatimit do duhet të parashikonte ndërtimin e pusetave të ujërave të shiut për grumbullimin e gjithë ujërave nga këto degëzime.
- Vihen re ulje, thyerje e plasaritje të pllakave në trotuare. Trotuarët nuk janë uniformë e me gjerësi të njëtrajtshme në të gjithë gjatësinë e saj, edhe pse rruga ka pasur mundësi zgjerimi të mjaftueshëm. Nuk është ndërhyrë për prishjen&spostimin e mureve rrethuese të ndërtesave, të cilat edhe pse duhet të jenë pa leje ndërtimi, zënë një pjesë të trotuarëve të saj.
- Nuk është respektuar sipas standardit të kërkuar lidhja e njëtrajtshme e trotuarëve me trupin e rrugës për personat me aftësi të kufizuar(në disa segmente ato pothuajse mungojnë fare).
- Nuk janë hequr fugat e drurit të përdorura nga firma zbatuese për lënien e fugave në të gjithë betonin e kunetave anësore të rrugës.
- Vihen re plasaritje të kunetave anësore të rrugës.

Edhe pse objekti sapo ka përfunduar dhe është brenda afatit të garancisë së punimeve, cilësia e punimeve të ndërtimit të veprës mund të vlerësohet kalueshëm. Bashkia Tiranë si investitore e këtij objekti, ka gjithë detyrimin ligjor për kontrollin e zbatimit të punimeve të ndërtimit (në cilësi dhe sasi).



Fig. 2
Plasaritje e kunetave anësore te rruges

Jemi të mendimit se nga mbikqyrësi i punimeve, por edhe nga Bashkia Tiranë ka pasur neglizhencë gjatë marrjes në dorëzim të punimeve të këtij segmenti rrugor, me vlerë investimi të konsiderueshëm. Të gjitha defektet e shfaqura, bashkia duhet tja bëjë prezente firmës zbatuese të punimeve e cila do duhet të bëjë riparimet e duhura, për të mos pritur degradimin e mëtejshëm të saj (fondi garancisë së punimeve të objektit është 5% e vlerës së situacionit përfundimtar).

Konkluzione në lidhje me objektin:

- *Do duhen të riparohen të gjitha uljet e plasaritjet e shtresave të asfaltit në trupin e rrugës, për të mos lejuar degradimin e mëtejshëm të saj.*
- *Të bëhet riparimi i trotuarëve duke zëvendësuar të gjitha pllakat e betonit të thyera, si dhe të riparohen uljet e tyre.*
- *Të riparohen të gjitha kalimet për personat me aftësi të kufizuara duke krijuar lidhje të njëtrajtshme të tyre, me trupin e rrugës e pa pengesa.*
- *Të bëhet riparimi i kunetave anësore të rrugës në pjesët e dëmtuara të saj, si dhe të hiqen fugat e drurit e të plotësohen me fuga betoni të varfër, konform kushteve teknike të projektimit e zbatimit.*
- *Sipas mendimit tonë vlera për riparimin e defekteve të konstatuara zë rreth 5 % të vlerës së situacionit përfundimtar. Bashkia Tiranë të realizojë inspektimin e objektit dhe të informojë zyrtarisht firmën zbatuese të punimeve për riparimin e të gjitha defekteve të evidentuara.*

Për të gjitha vërejtjet e mësipërme jemi mbështetur në nenet e praktikave standarde të kontratave të zbatimit të punimeve, si dhe në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr. 3, datë 15.01.2001, Nr. 2, datë 13.05.2005 dhe Nr. 1, datë 16.06.2011, "Për mbikqyrjen dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit".

Bashkëlidhur një foto ajrore e zonës ku është investuar.
(me vijë blu është shënuar rruga ku është kryer rikonstrukcioni)

